

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Speciales/ Hamza: Një ditë turpi për drejtësinë ndërkombëtare
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/vendimi-i-speciales-hamza-nje-dite-turpi-per-drejtesine-n-derkombetare/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:17:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e3c837a3c2d611dcf2ba4750774773d97b6c2d6f1ac4637410a2d3455da369c5
TEKSTI	5b11d0470d1d32a72964f96380d7c4daf45a2db0908d97b5a966aa2acdc03798
PAMJA	4d977530215d3c2e8d661b97ad8cb1649c743edfb1942dc3b6d34690115a4d85

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	32dbd822d3fe51042fa1c9cd24bb6257d321ebf60eafe7e4f852e88c80a2c7ed
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/32dbd822d3fe51042fa1c9cd24bb6257d321ebf60eafe7e4f852e88c80a2c7ed>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > RAJONI

Vendimi i Speciales/ Hamza: Një ditë turpi për drejtësinë ndërkombëtare

15:12 : 16/09/2026 në RAJONI



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza ka thënë se sot është një ditë e rëndë për Kosovën, një ditë e zezë, por edhe një ditë e turpit për drejtësinë ndërkombëtare.

Hamza në një konferencë për media ka thënë se aktgjykimi i sotëm ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit ka sjell dhimbje dhe zhgënjim të thellë tek të gjithë ne.

“Një dhimbje e zhgënjim që nuk e kemi pritur. Mendjet dhe zemrat tona, para së gjithash, sot janë me Hashim Thaçin, me Kadri Veselin, me Jakup Krasniqin e me Rexhep Selimin dhe me familjet e tyre, të cilat për gati gjashtë vjet e kanë bartur peshën e këtij procesi. Por, të lënduar, të zhgënjyer, të mllëfësuar jemi edhe ne, të gjithë ne, qytetarët e Kosovës dhe tërë shqiptarët në botë. Vendimi i shqiptuar sot nuk është bërë në emër të popullit të Kosovës”, ka thënë Hamza.

Deklarata e plotë:

Lexo edhe:

Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri

A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkruar Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?

Sot është një ditë e rëndë për Kosovën. Një ditë e zezë. Por, është edhe një ditë e turpit për drejtësinë ndërkombëtare.

Aktgjykimi i sotëm ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit ka sjell dhimbje dhe zhgënjim të thellë tek të gjithë ne.

Një dhimbje e zhgënjim që nuk e kemi pritur.

Mendjet dhe zemrat tona, para së gjithash, sot janë me Hashim Thaçin, me Kadri Veselin, me Jakup Krasniqin e me Rexhep Selimin dhe me familjet e tyre, të cilat për gati gjashtë vjet e kanë bartur peshën e këtij procesi.

TË GJITHA



Vendimi i Speciales/ Hamza: Një ditë turpi për drejtësinë ndërkombëtare

15:12 : 16/09/2026



Taksistët protestë para Bashkisë së Tiranës: Të mos jepen licenca pa limit

15:08 : 16/09/2026



Këto 3 shenja do të lënë pas vështirësitë

15:01 : 16/09/2026



BE propozon mekanizëm emergjent për fluksin e emigrantëve

14:50 : 16/09/2026




Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri

14:32 : 16/09/2026



Tiranë/ Zbulohet një lokal i përshtatur për shitje droge dhe lojëra fati, arrestohet pronari

14:32 : 16/09/2026



Jorida Tabaku reagon pas vendimit të Hagës: Një ditë e rëndë për çdo shqiptar

14:20 : 16/09/2026

Por, të lënduar, të zhgënjyer, të mllëfosur jemi edhe ne, të gjithë ne, qytetarët e Kosovës dhe tërë shqiptarët në botë.

Vendimi i shqiptuar sot nuk është bërë në emër të popullit të Kosovës.

Vendimi i shqiptuar sot është bërë kundër popullit të Kosovës, kundër shtetit të Kosovës.

Ne e kemi përcjellë këtë proces me besimin se në fund drejtësia do të mbështetet vetëm në fakte, në prova dhe në përgjegjësi individuale.

Por, sot nuk pamë drejtësi.

Në Hagë sot u godit rëndë rezistenca e popullit tonë.

U fye sakrificat e popullit tonë që luftoi për liri, mbijetesë dhe çlirim nga regjimi shtetëror serb që vrau, dëboi dhe terrorizoi shqiptarët e Kosovës.

Për ne, ky aktgjykim është një padrejtësi e madhe, sepse atje u dënuan ata që rininë dhe jetën e tyre ia kushtuan lirisë.

Kësaj lirie që sot e gëzojmë të gjithë në Kosovë.

Ata katër sot u dënuan për gjithçka që është propaganduar për luftën e UÇK-së dhe për evidenca rastesh që janë mbyllur nga UNMIK-u dhe EULEX-i në dy dekadat e pas luftës.

U dënuan edhe sepse e kanë mbrojtur luftën e UÇK-së nga faktorë të jashtëm, që shpeshherë kanë qenë të shtyrë nga vetë regjimi serb për ta shuar rezistencën tonë.

Po ashtu, ai vendim mbështetet edhe në pretendime e materiale që i konsiderojmë të fabrikuar dhe të ushqyera ndër vite nga aparati shtetëror dhe propaganda e Serbisë për ta kriminalizuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

U dënuan, ndër tjera, edhe pse ushtarët e UÇK-së kanë ndaluar dhe legjitimuar serbë në zonat e UÇK-së gjatë luftës.

Madje, u dënuan edhe për raste që Tribunali Ndërkombëtar i Hagës kishte shpallur pafajësi më herët.

Qytetarë të nderuar,

Ky aktgjykim sot u shqiptua në Hagë. Por historia e Kosovës është shkruar këtu, me sakrificë, gjak dhe luftë për liri.

Dhe ajo nuk rishkruhet sot.

Historia jonë është shkruar nga populli ynë që luftoi për mbijetesë, nga mijëra dëshmorë e martirë, nga qindra mijëra qytetarë të dëbuar prej shtëpive të tyre dhe nga një aleancë historike me botën demokratike që, në vitin 1999, i dha fund represionit dhe spastrimit etnik të regjimit serb në Kosovë.

Ata katër gjatë dy viteve të luftës ishin në koordinim edhe me aleatët tanë dhe sot u dënuan edhe këto aleanca.

Sot, qytetarët e Kosovës, janë të lënduar dhe të zhgënjyer nga ky aktgjykim i padrejtë, i cili është një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës.

Nuk ka fat popujsh e shtetesh që ndërlidhet me shumë sesa fati i popullit dhe shtetit tonë me emrat e tyre.

Prandaj, sot të dënuar jemi të gjithë, si popull dhe si shtet.

Sot është një ditë e rëndë për Kosovën. Por sot nuk përfundon as historia, as beteja jonë për të vërtetën.

Procesi juridik nuk ka përfunduar dhe fjala e fundit e drejtësisë ende nuk është thënë.

Nuk është e njëjta gjë të provohet se gjatë luftës janë kryer krime dhe të provohet se katër individë të caktuar kanë pasur një qëllim të përbashkët kriminal për kryerjen e tyre.

Për secilin prej të akuzuarve duhet të provohet, jo vetëm pozita që ka mbajtur, sepse pozita në një strukturë nuk mund ta zëvendësojë provën e nënrietiçsisë individuale

Gjatë këtij procesi janë dëgjuar dëshmi të rëndësishme për strukturën dhe funksionimin real të UÇK-së.

Njerëz që gjatë viteve 1998 dhe 1999 kishin kontakte të drejtpërdrejta me UÇK-në, përfshirë përfaqësues të lartë amerikanë dhe të NATO-s, të cilët kanë dëshmuar për natyrën e decentralizuar të organizimit të saj dhe për kufizimet e strukturës së komandës dhe kontrollit.

Këto dëshmi nuk e përcaktojnë vetvetiu rezultatin e një procesi gjyqësor.

Por ato kërkojnë përgjigje: si janë peshuar përballë konkluzionit se ekzistonte një qëllim i përbashkët kriminal që formulohej dhe zbatohej përmes strukturave të UÇK-së?

Si është përcaktuar autoriteti real i secilit të akuzuar dhe përgjegjësisë së tyre individuale?

Po aq i rëndësishëm është një konstatim tjetër i aktgjyimit të sotëm.

Edhe çështja e dëshmitarëve kërkon vëmendje të veçantë.

Vetë Paneli ka folur për probleme serioze me dëshmitë e disa prej tyre.

Prandaj duhet parë me rigorozitet sesi janë vlerësuar deklaratat e ndryshme, si janë trajtuar kundërtëhëniet dhe mbi cilat dëshmi janë mbështetur konkluzionet vendimtare për fajësinë.

Në fund, të gjitha këto çështje kthehen te një standard i vetëm: përtej dyshimit të arsyeshëm.

Në të drejtën penale nuk mjafton që një version i ngjarjeve të jetë i mundshëm, apo edhe më bindës se një tjetër.

Kur një njeri dënohet me 13, 18 apo 25 vjet burg, fajësia e tij individuale duhet të jetë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Prandaj presim që në Apel të shqyrtohen me rigorozitet të plotë konkluzionet mbi qëllimin e përbashkët kriminal, përgjegjësinë individuale, autoritetin dhe kontrollin real, vlerësimin e dëshmive dhe çdo çështje faktike apo juridike që mund të ketë ndikuar në aktgjykim.

Sepse e drejta e Apelit ekziston pikërisht që një aktgjykim me pasoja kaq të rënda t'i nënshtrohet edhe një herë provës së ligjit, të fakteve dhe të standardit më të lartë të drejtësisë.

Partia Demokratike e Kosovës do të jetë në përkrahje të luftës së drejtë dhe të pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Do të jetë në përkrahje të plotë të udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme demokratike dhe ligjore, që kanë të bëjnë me këto procese.

Etiketa: Bedri Hamza gjykata e hages

Lajme të lidhura



Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I



A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkrirë Givkatën



Haxhiu pas aktgjyimit në Hagë: Fjala e fundit juridike nuk është

padrejtë, askush se njolet dot luftën e shqiptarëve për liri

14:32 : 16/09/2026



Gjyqi në Hagë/ LDK thirrje partive: Të bëhemi bashkë! Momenti i vështirë për Kosovën

13:02 : 16/09/2026

Speciale të Kosovës në Hagë?

14:19 : 16/09/2026



81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, publikohet aktgjykimi i plotë Gjykatës Speciale në Hagë (Dokumenti)

12:32 : 16/09/2026

thënë

13:39 : 16/09/2026



Vendimi në Hagë/ Hyseni dhe Gjini: Drejtësia mund të çënohet, por historia nuk ndryshohet

12:27 : 16/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.